KËRKESË
Nr. 794/8, datë 18.9.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 206, datë 6.4.2022, të Këshillit të Ministrave, 'Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore, nyja e Milotit'"', me vlerë totale paraprake të shpronësimit 622 720 (gjashtëqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e njëzet) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasurinë e llojit "arë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 622 720 (gjashtëqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e njëzet) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE PASURITË, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 206, DATË 6.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, 'PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'PËRFUNDIMI I PUNIMEVE TË MBETURA DHE PLOTËSIMI ME RRUGË DYTËSORE, NYJA E MILOTIT'"'

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Vlerësimet për shpronësim			Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale	Sip. e shpronësuar (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera lekë		
	Kujtim Sinan Lule Lindita Besim	Baftjar Baftjar Baftjar Baftjar Baftjar	Isufi Isufi Tuga Hidri Isufi	3441	5/15	Arë	3.200	2240	278	622,729.00	622,729.00	
	Vlera totale paraprake									**622,729.00**		